



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 84 Prot

Tiranë, më 22/01/2015

URDHËR

Nr. 14, datë 22/01/2015

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS”

Në mbështetje të neneve 6 dhe 8, pika 2 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

URDHËRON:

1. Miratimin e programit model të transparencës, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.
2. Miratimin e standartit për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur.
3. Miratimin e modelit të kërkesës dhe përgjigjes “Për dhënie të informacionit/ dokumentacionit” që rekomandohet të përdoret nga Autoritetet Publike, sipas lidhjes nr. 3, bashkëlidhur.
4. Miratimin e akteve shkresore që rekomandohen të përdoren nga Autoritetet Publike, për vendimmarrjet, sipas lidhjes nr. 4, bashkëlidhur:
 - a. “Për refuzimin e formës së kërkuar”, (neni 14/4);
 - b. “Për zgjatjen e afatit”, (neni 15/3);
 - c. “Për rishikimin e dokumenteve të klasifikuara dhe shtyrjen e afatit”, (neni 17/5).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletore zyrtare.

